

Valentina Maloku

### **Biografia në Shqip**

Valentina Maloku është themeluese e kompanisë B2B Communication Shpk – kompani e konsulencës me bazë në Kosovë. Valentina është e licensuar si eksperte për transformim digjital dhe siguri të informacionit dha ka përvojë pune më shumë se 14 vite në sektorin e Teknologjisë Informative, si me kompani vendore, poashtu edhe ndërkombetare. Ajo është kontraktuar në disa projekte qeveritare si menaxhere e projekteve për digjitalizim të sistemeve të informacionit të institucioneve të Republikës së Kosovës. Me një bagazh të pasur profesional, Valentina ka dëshmuar për profesionalizmin e saj në shumë projekte që ajo ka menaxhuar si në kompani lokale, ndërkombëtare poashtu edhe qeveritare. Për shkak të njohurive të saj multidimensionale në shumë fusha dhe industri, dhe duke qenë në pozita ekzekutive gjatë gjithë karrierës së saj, ajo është njëra nga konsulentet e cila ofron vlerë për secilin projekt që ajo angazhohet.